




Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës Opština Podujevo Municipality of Podujeva

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK



PROJEKTI / FESTIVALI:

Ditët e fundvitit

QËLLIMI

Projekti ka synim që me rastin e festave të fundvitit dhe fluksit të ardhjes së mërgimtarëve, si dhe nevojes për ngritjen e turizmit të brendshëm, pasurimin e jetës kulturore, të rrisë gamën e aktiviteteve argëtuese dhe promovuese për qytetarët e Komunës së Podujevës, mbështetjen e bizneseve përmes vendosjes të gjashtë (6) shtëpizave të drurit, ku do të ofrohen shërbime të gastronomisë në sheshin “Sheshi i Dëshmorëve” në Podujevë.

RREGULLAT

1) Vendi dhe orari i punës

Hapja e festivalit bëhet me datën **15.12.2022** në sheshin “Sheshi i Dëshmorëve” dhe do të qëndrojë hapur deri më datën **05.01.2023**.

Gjatë kësaj kohe Bizneset e përzgjedhura për shtëpiza lejohen të punojnë çdo ditë nga e hëna në të dielën duke filluar prej orës **08:00** deri në orën **23:00**.

2) Kriteret e aplikimit

Aplikimi i kritereve si më poshtë do të jetë përcaktues në mënyrë që përzgjedhja e Bizneseve të jetë sa më adekuate:

- Bizneset aplikuese duhet të janë të regjistruara dhe të kenë aktivitet primar fushën e gastronomis.
- Bizneset aplikuese duhet të paraqesin ofertën me çmimore për artikujt që do t'i ofrojnë, çmimore e cila do të jetë në fuqi deri në mbyllje të festivalit.

3) Përparësi në përzgjedhje do të kenë:

Përzgjedhja e Bizneseve të cilat do të janë pjesëmarrëse në këtë aktivitet do të bëhet nga komisioni i përcaktuar nga Komuna e Podujevës.

- Bizneset të cilat promovojnë dhe shërbejnë produktet vendore;
- Bizneset që ofrojnë produkte konsumi inovative (të reja) në fushën e gastronomisë, dhe produkte që kanë të bëjnë me motive të stinës së dimrit (këtu nuk përfshihen produktet e skarës dhe kuzhinës në përgjithësi);
- Bizneset që ofrojnë dëshmi për punëtorët e deklaruar në ATK;
- Përparësi në përzgjedhje kanë bizneset të cilat kanë përvojë dhe janë dëshmuar të sukseshëm në fushën e gastronomis;

4) Kodi mirësjelljes dhe obligimet shtesë

- *Komuna e Podujevës gjatë ditëve të festivalit ndalon rreptësisht kryerjen e akteve të paligjshme dhe të dhunshme brenda zonave të zhvillimit të festivalit; abuzimin verbal ose fizik të personave, të cilët përfaqësojnë bizneset shitëse/konkurruese si dhe të blerësve apo qytetarëve të tjera kalimtarë;*
- *Ndalohet përdorimi i skarës dhe përgatitja e ushqimeve nga kuzhina përgjithësisht.*
- *Obligohen të gjitha Bizneset e përzgjedhura që pas përfundimit të orarit të punës të pastrojnë shtëpizën e tyre dhe hapësirën përreth tyre;*
- *Të gjitha Bizneset duhet t'u përbahen obligimeve që dalin nga kontrata me Komunën e Podujevës për shfrytëzimin e shtëpizave të drurit.*
- *Bizneset përfituese të gjitha shërbimet gastronomike duhet t'i ofrojnë/shërbejnë në ambalazh një përdorimshe, material nga letra ose plastika. (Ndalohet përdorimi i shishevë dhe gotave nga qelqi);*
- *Bizneset e përzgjedhura do t'u lejohen vetëm 4 banake para shtëpizave të tyre;*
- *Bizneset e përzgjedhura do ta kenë obligative që afér shtëpizës ta kenë shportën për mbeturina.*
- *Bizneset aplikuese duhet të jenë të pajisura me mjete/vegla të përshtatshme pune për veprimtarinë të cilën do ta ushtrojnë në Festival;*
- *Të gjitha bizneset e përzgjedhura obligohen t'i marrin përsipër shpenzimet e energjisë elektrike, shpenzimet e pastrimit të shtëpizave, si dhe shpenzimet e sigurimit fizik për përperiudhën e shfrytëzimit të shtëpizave. Pagesa bëhet përmes ndarjes proporcionale të borxhit total, në momentin që paguhet fatura totale e shfrytezimit të hapësirës.*
- *Aplikuesit e përzgjedhur janë të obliguar t'i dekorojnë shtëpizat në bazë të dekorit të përcaktuar nga Komuna e Podujevës, pasiqë të gjitha shtëpizat duhet të kenë pamje të njëjtë;*
- *Të gjitha Bizneset janë të obliguara të tregojnë frymë bashkëpunimi të mirëfilltë në mes tyre, në mënyrë që ky bashkëpunim të jetësohet sa më mirë.*

5) Mënyra e aplikimit

- *Aplikuesit kanë të drejtë aplikimi vetëm një herë me kartelën identifikuese të një personi juridik. Me rastin e aplikimit, kërkohet kopja e letërnjoftimit.*
- *Oferta apo çmimorja dorëzohet sipas formave standarde që Bizneset përdorin në veprimtaritë e tyre.*
- *Aplikuesit në aplikim duhet t'i bashkangjesin dokumentet përcjellëse: kopjet e çertifikatës së regjistrimit të Biznesit dhe numrin fiskal.*
- *Afati për aplikim: 06.12.2022 deri më 12.12.2022 prej orës 08:00 - 16:00 | Komuna e Podujevës – zyra pritëse e Komunës.*
- *Të përzgjedhurit do të njoftohen se kur duhet të paraqiten në objektin e Komunës së Podujevës për nënshkrimin e kontratës, dhe procedurat e mëtutjeshme.*

VËREJTJE

- *Komuna e Podujevës nuk merr përsipër përgjegjësinë dhe obligimet ndaj Administratës Tatimore të Kosovës rreth arkës fiskale, andaj obligohen të gjitha bizneset e përzgjedhura që kuponët fiskalë t'i vërtetojnë (vulosin) në Administratën Tatimore të Kosovës.*
- *Nëse nuk zbatohet kodi i mirësjelljës i sqaruar më lart, Bizneset do të sanksionohen me shkëputjen e kontratës për shtëpizë dhe në të ardhmen nuk do të mund t'i shfrytëzojnë këto shtëpiza.*
- *Çdo Biznes përfitues për shfrytëzimin e shtëpizës është i obliguar që veprimtarinë ta ushtrojë vetë e jo ta bartë te palët e treta.*
- *Afati për aplikim zgjatë 5 ditë pune, nga dita e publikimit.*
- *Për çdo paqartësi mund të kontaktoni përmes E-mail: genc.gashi@rks-gov.net, Nr.kontaktues: 038 200 41 033*